

[15.08.1998] në **Sllup/Slup**. U varros në varrezat Barunovc në Rumë.

**Burimet:** deklarata P.U, FDH-27784; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 72; SMIP, *Teroristički...*, III, 979.

## Ajmone (Avdyl Bushati)

### Mazrekaj

(1924, shqiptarë nga Vokshi/Vokša, komuna e Deçanit/Deçani, dy fëmijë)

Ajmonja e moshuar jetonte te i biri Uka dhe familja e tij. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin e tyre [**Voksh/Vokša**] më 1.06.1998, godine, Uka me familje kaluan në Shqipëri, si edhe bashkëfshatarë të tjerë. E ëma, e cila ishte e palëvizshme, ka mbetur në shtëpi. Në datën **15.08.1998**, gjatë takimit me disa bashkëfshatarë, të cilët e kanë braktisur Vokshin/Vokša më vonë, Uka ka mësuar se e ëma ka qenë mirë, se për të kujdeseshin pjesëtarë të UÇK-së dhe se ishte vendosur në shtëpinë e familjes Kukulaj. Gjatë tërë luftës, familjarët e Ajmones nuk dëgjuan më asgjë tjetër për të. Pas kthimit nga vend, në fund të muajit qershor të vitit 1999, Uka ka shkuar te shtëpia e familjes Kukulaj. Shtëpinë e ka gjetur të shkruar. Për fatin e Ajmones nuk dihet asgjë as sot. Është e regjistruar si e zhdukur dhe KNKK e ka evidentuar rastin e saj në dosjen me numrin rendor BLG-803262-01.

**Burimet:** deklarata U.M, FDH-18716; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

## Zdravko (Mitar) Miskin

(1.02.1957, serb nga Novi Sadi, tre fëmijë, toger i klasës së parë në MPB-në e Republikës së Serbisë)

## Gojko (Mirko) Vojnović

(3.12.1958, serb nga Vrbasi, dy fëmijë, toger i klasës së parë në MPB-në e Republikës së Serbisë)

## Dragoljub (Nenad) Šuković

(13.11.1960, serb nga Pançeva, dy fëmijë, kapiten në MPB-në e Republikës së Serbisë)

## Milorad (Stevo) Rađenović

(16.05.1962, serb nga Vrbasi, dy fëmijë, major në MPB-në e Republikës së Serbisë)

## Nikola (Stojan) Vujičić

(13.10.1970, serb nga Zrenjanini, dy fëmijë, toger në UJ-në)

Nikola e kishte mbaruar akademinë ushtarake. Ka marr pjesë në luftën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Në Kosovë e mbante postin e komandantit të togut dhe zëvendës komandantit të togut të policisë ushtarake. Miloradi ishte komandant i stacionit policor në Vrbas. Në të njëjtin stacion punonte edhe Gojko, si pjesëtar i policisë rrugore. Zdravko punonte në Sekretariatin e Punëve të Brendshme të Novi Sadit, ndërkaq Dragoljubi në Sekretariatin e Punëve të Brendshme të Pançevës.

Në datën **15.08.1998**, herët në mëngjes, Miloradi, Gojko, Zdravko, Dragoljubi dhe Nikola ishin nisur për të vëzhguar terrenin përreth fshatit **Voksh/Vokša**. Pjesëtarët e UJ-së i kanë hedhur gabimisht dy predha minahedhëse mbi ta. E para ka dështuar, ndërkaq predha e dytë i ka qëlluar për vdekje që të gjithë ata.

Miloradi dhe Gojko u varrosën njëri pranë tjetrit në varrezat e Vrbasit. Zdravkon e kanë varrosur më 17.08.1998 në varrezat e Nova Gajdobra. Po atë ditë, në Varrezat e Reja të Pançevës u varros Dragoljubi.

**Burimet:** deklarata M.V, FDH-25389; deklarata M.M, FDH-25824; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 19, 20, 45, 46, 58, 75; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; Z. Stijović, *Kosmet...*, 109,110; SMIP, *Teroristički...*, III, 937, 938, 979.

## Sefer (Ahmet) Mehmeti

(27.09.1916, shqiptar nga Brovina/Brovina, komuna e Gjakovës/Đakovica, pylltar, tre fëmijë)

Seferi dhe Nifa me djemtë Bashkimin dhe Bekimin dhe vajzën Kosovaren jetonin në fshatin Brovinë/Brovina. Para verës së vitit 1998, kaluan në shtëpinë e boshatisur të familjarëve të Seferit, në fshatin Gjocaj/Đocaj. Bekimi aderoi në radhët e UÇK-së, ndërkaq Seferi dhe Nifa ndenjën me djalin e dytë dhe vajzën. Nuk kaloi shumë kohë dhe Nifa u plagos gjatë bombardimit të fshatit nga ana e forcave serbe. Në datën **18.08.1998**, forcat serbe kanë hyrë në **Gjocaj/Đocaj**. Bashkimi e ka bartur nënën